



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 19.02.2024

Nr: 7

Ora: 12:00

VENDIM

PËR SHQYRTIM E KËRKESËS ANKIMORE NR. 1, DATË 14.02.2025, DEPOZITUAR
NGA “KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.02.2025, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ilijan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

OBJEKT: Ankim kundër pikës 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Neni 124/1, pika 2 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Rrethanat e çështjes:

1. Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 06.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet protokollit, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 4 ID.
2. Në këtë denoncim KRIIK ka denoncuar miratimin e projektligjit "Për një shtesë në ligjin 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 30 janar 2025 dhe ka kërkuar që "KQZ-ja të ndër marrë sa më parë hapat e nevojshëm për të parandaluar shtrirjen e efekteve të këtij projektligji dhe ngrirë atë në fazën ku ndodhet, duke mos lejuar hyrjen në fuqi të tij". KRIIK ka konsideruar të nevojshme që "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të vendoset sa më parë në komunikim të drejtpërdrejtë me Institucionin e Presidentit të Republikës për mosdekretimin dhe kthimin në Kuvendin e Shqipërisë të projektligjit të mësipërm". Gjithashtu, KRIIK ka kërkuar që "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të zbatojë me rigorozitet shkronjën e ligjit duke nisur hetimin administrativ lidhur me këtë shkëlqje të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, si dhe vendosur sanksionet përkatëse në zbatim të nenit 171 të Kodit Zgjedhor".
3. Me vendimin nr. 73, datë 10.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi. Më datë 11.02.2025, ora 15:00, u zhvillua seanca publike për këtë shqyrtim administrativ. Në këtë seancë në cilësinë e përfaqësuesve të Kuvendit u paraqitën zj. Mimoza Arbi, me detyrë Drejtor i Shërbimit Juridik dhe zj. Elvira Domi me detyrë Këshilltare në Shërbimin Juridik pranë Kuvendit, të cilat i qëndruan pretendimeve të depozituara me e-mail në KQZ. Në përfundim të seancës publike KSHZ, miratoi vendim me nr. 83, datë 11.02.2025, "Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 4, datë 06.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
4. Nga vlerësim të pretendimeve të palëve, fakteve dhe provave të administruara në këtë shqyrtim administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmoi se kërkimi sipas objektit i KRIIK nuk është i mbështetur në ligj. Akti i denoncuar ishte miratuar nga Kuvendi përpara depozitimit të denoncimit dhe pika 4 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor nuk mund të aplikohet më. Gjithashtu kjo dispozitë nuk i mund të aplikohet as përse i takon kompetencës së Presidentit të Republikës për dekretimin e ligjit.
5. Më tej, Komisioneri mori në shqyrtim, në kuadër të këtij procedimi, dy projektligje, projektligjin "Për paketën e maleve" dhe projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" dhe konstatoi, se ndryshimet e propozuara kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar, se çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve dhe se ato mund të krijojnë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale. Mbi këtë bazë, Komisioneri vendosi t'i rekomandojë Kuvendit të Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjin "Për paketën e maleve" dhe projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".

6. Kundër këtij vendimi është bërë ankim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me pretendimin se dy projektligjet nuk bëjnë pjesë në kategorinë e nismave që ndalohen nga pika 4 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor.
7. Sipas rregullores së punës, KAS-i caktoi me short anëtarin Elvis Çefa si relator të çështjes dhe në datën 17.02.2025 zhvilloi senacën paraprake me pjesëmarrjese e përfaqësuesve të ankuesit zj. Mimoza Arbi, me detyrë Drejtor i Shërbimit Juridik dhe zj. Elvira Domi me detyrë Këshilltare në Shërbimin Juridik pranë Kuvendit, si dhe me pjesëmarrjen e z. Erion Braçe, deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, nismëtar i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Seanca vendosi të pranojë për shqyrtim kërkesën ankimore.
8. Në seancën e shqyrtimit të datës 19.02.2025 ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuesi i palës ankimuese, zj. Mimoza Arbi, zj. Elvira Domi, dhe z. Erion Braçe.
9. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 1, datë 14.02.2025, depozituar nga “Kuvendi i Republikës së Shqipërisë”;
 - Vendimin nr. 83 datë 11.02.2025 “Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 4, datë 06.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK”;
 - Ligjin nr. 9/2025 “Për një ndryshim në ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar”.
 - Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”;
 - Projektligji “Për Paketën e Maleve”.
 - Korrespondencën nëpërmjet postës elektronike.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi:

1. Pika 4 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se “katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve **ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore** ose nënligjore, të cilat **parashikojnë dhënien e përfitimeve** për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që **parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”.**

2. Pika 3 e nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator ka shtuar në listën e akteve të ndaluara edhe aktet më të cilat bëhet falja e kamatëvonesave, gjobave, detyrimeve tatimore e doganore.
3. Dispozitat ndaluese të mësipërme ndjekin një qëllim të qartë, atë të ndalimit të dhënies së lehtësive, ndihmave, përfitimeve me karakter financiar dhe/ose pasuror për kategori të caktuara të popullsisë, në një periudhë specifike para dhe pas zgjedhjeve, sepse këto lehtësi, ndihma apo përfitime mund të jepen me synimin e hapur ose të fshehtë për të ndikuar vullnetin e zgjedhësve, në zgjedhjet për Kuvendin. Për ndalimin nuk paraqet rëndësi fakti se dhënia e lehtësive, ndihmave apo përfitimeve është pjesë e angazhimeve, platformave dhe politikave qeverisëse të para deklaruara, apo është pjesë e premtimeve zgjedhore. Këto ngjarje nuk mund të ndodhin në periudhën që fillon katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve.
4. Dispozitat kanë përcaktuar natyrën dhe llojin e akteve që ndalohen. Për nga lloji, dispozita ndalon, sipas rastit, propozimin, miratimin ose nxjerrjen e **akteve ligjore ose nënligjore**. Për nga lloji, aktet që ndalohen janë akte me karakter normativ, akte që rregullojnë një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe që nuk shterohen në zbatimin e tyre (pika 2 e nenit 3 të KPrA). Për nga natyra, aktet që ndalohen duhet të kenë të bëjnë me rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, faljen e kamatëvonesave, gjobave, apo detyrimeve tatimore e doganore etj.
5. Lista e shembujve që jep dispozita nuk është ezauruese, por natyra e akteve të pa përfshira në mënyrë të shprehur duhet të ketë karakteristika të njëjta me ato të cituara në dispozitë. Shembujt e dhënë në dispozitë nuk i referohen përfitimeve të natyrës jo materiale, të tilla si masa që kanë lidhje me statusin ligjor të personave të caktuar, apo me regjimin juridik të trajtimit të tyre, apo me privilegje ose përparësi në trajtim, të cilat propozohet që të veprojnë për kategori të caktuara të popullsisë. Që përfitimet jo materiale të trajtohen nga KAS-i si të përfshira në ndalimin sipas pikës 4 të nenit 91 do të duhet që Rregullatori t'i përfshijë ato në pikën 3 të nenit 3 të vendimit të tij nr. 9, datë 24.12.2020.
6. Në zbatim të pikës 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe të pikës 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Rregullatorit, KAS-i konstaton se karakteristika e përbashkët e masave qeveritare që ndalohen ka të bëjë, së pari, me parashikime për alokim fondesh buxhetore në favor të kategorive të caktuara të popullsisë, ose me ndërprerjen ose pezullimin e vjeljes së detyrimeve nga kategori të caktuara të popullsisë. Në një vlerësim të përgjithshëm, **këtu bëjnë pjesë masa në favor të kategorive të caktuara të popullsisë, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në buxhetin e shtetit, në zërin e të ardhurave, ose në atë të shpenzimeve**. I njëjti arsytim vlen edhe për masa që ndikimin e tyre nuk e kanë mbi buxhetin, por e kanë mbi pasurinë publike ose shtetërore dhe që formojnë kategorinë e dytë të masave. **Qeveria nuk mund të propozojë, miratojë apo nxjerrë akte, me të cilat disponohet mbi pasurinë e shtetit, në favor të kategorive të caktuara të popullsisë, ose me të cilat ndërpriten, ose pezullohen kërkimet (pretendimet) e ligjshme mbi pasurinë që disponohet nga këto kategori**.

7. Dispozita flet për kategori të caktuara të popullsisë, gjë që në interpretim literal nënkupton grupe individësh të përcaktueshëm qartë. Numri i individëve që formojnë kategorinë nuk është i rëndësishëm për dispozitën, por rëndësia e këtij numri duhet gjithmonë të vlerësohet në kontekstin e ndikimit që ata mund të kenë mbi zgjedhjet. **Si rregull, një masë qeveritare e llojit të një akti ligjor ose nënligjor nxirret me efekt të përgjithshëm ose me efekt mbi një numër të lartë subjektësh.** Por masat mund të kenë përfitues një numër të vogël individësh, të cilët nga ana e tyre kanë mundësi që të ndikojnë mbi një numër të lartë zgjedhësish. Në këtë kontekst do të përfshihej në fushën e veprimit të ndalimit p.sh. akordimi i lehtësive fiskale mbi një kategori ekskluzive subjektësh të privilegjuar, por që nga ana e tyre punësojnë dhe, për shkak të kësaj marrëdhënieje, mund të ndikojnë mbi një numër të konsiderueshëm zgjedhësish. Për këtë arsye, termi **“kategori e caktuar e popullsisë”** duhet të çmohet rast pas rasti në funksion të motivimit dhe mundësisë faktike që kategoria ka për të ndikuar mbi vullnetin elektoral të kategorive më të mëdha të popullsisë.
8. Përcaktimi për llojin e aktit (akt me karakter normativ) dhe për subjektet përfituese (kategori të caktuara të popullsisë, jo subjekte të veçanta) përjashton nga fusha e veprimit të ndalimit aktet me karakter individual apo kontratat që shteti lidh me subjektet private. Kjo dispozitë nuk ndalon kryerjen e një procedure privatizimi a legalizimi, dhënien e një autorizimi, apo miratimin e një koncesioni. Të gjitha këto janë akte individuale. Eventualisht lidhur me to mund të veprojnë ndalime të tjera, por jo ndalimi i përcaktuar në pikën 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.
9. Komisioneri, me vendimin nr. 83, datë 11.02.2025 ka marrë në shqyrtim denoncimin e administruar më datë 06.02.2025 në regjistrin e denoncimeve me nr. 4 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK). Objekt i këtij denoncimi ka qenë ligji “Për një shtesë në ligjin 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, i miratuar në seancën plenare të datës 30 janar 2025 nga Kuvendi i Shqipërisë. Komisioneri e ka çmuar kërkimin e KRIIK sipas objektit, si të pa mbështetur në ligj, sepse “KQZ, në zbatim të pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, nuk mund të disponojë në çfarëdo lloj forme mbi një akt që është miratuar nga organi kompetent”.
10. Denoncimi i regjistruar me nr. 4 ID parashtronte këto kërkitime për Komisionerin:
- të ndërmerren sa më parë hapat e nevojshëm për të parandaluar shtrirjen e efekteve të këtij projektligji dhe ngrirë atë në fazën ku ndodhet, duke mos lejuar hyrjen në fuqi të tij. Për këtë qëllim, denoncuesi kërkonte që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të vendoset sa më parë në komunikim të drejtpërdrejtë me Institucionin e Presidentit të Republikës për mos-dekretimin dhe kthimin në Kuvendin e Shqipërisë të projektligjit të mësipërm;
 - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të nisë hetimin administrativ lidhur me këtë shkelje të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, si dhe të vendosë sanksionet përkatëse në zbatim të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.
11. KAS-i çmon se një kërkesë eventuale e KQZ-së, drejtuar Presidentit të Republikës, për të kthyer për rishqyrtim ligjin nuk gjen bazë ligjore në pikën 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Kjo dispozitë prek veprimtarinë e organeve kompetente për propozimin, miratimin dhe nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore, por nuk shtrihet dot mbi kompetencën e Presidentit të Republikës për të

shpallur aktin e miratuar ose për ta kthyer atë për rishqyrtim. Në këto kushte, KAS-i e gjen të justifikuar refuzimin e Komisionerit për t'iu përgjigjur pozitivisht kërkesës të parë të KRIIK-ut.

12. Sa i takon kërkesën të dytë, Komisioneri ka patur detyrimin që përgjatë shqyrtimit të denoncimit të analizonte përmbajtjen e ligjit të miratuar, për të zbuluar nëse akti ishte miratuar në kushtet e ndalimit, ose jo. Miratimi i akteve ligjore në kundërshtim me pikën 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi administrative Kryetarin e Kuvendit, sepse është Kryetari i Kuvendit, i cili bart detyrimin për “të marrë masa për të mos vendosur ose për të propozuar që të mos vendosen në rend të ditës për shqyrtim dhe miratim”, aktet e kësaj natyre (pika 5 e nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator). Në rast se vërtetohet kundërvajtja administrative, atëherë Komisioneri mund të jetë në kushtet e detyrimit për vendosjen e sanksionit administrativ.
13. Ligji nr. 9/2025 “Për një ndryshim në ligjin nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar” ka shtyrë me dy vjet afatin e veprimit të një përjashtimi fiskal për një rreth të kufizuar subjektsh. Sipas dispozitave në fuqi përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përjashtoheshin nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat korporative, entitetet, që operojnë në struktura akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special” sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarësh “brand name”, në rast se statusin special do ta përfitonin deri në dhjetor 2024. Ligji i ri ka zëvendësuar afatin “dhjetor 2024” me afatin “dhjetor 2026”.
14. Analiza e fakteve, e mbështetur nga dokumentacioni referues parlamentar, tregon se përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat korporative është në fuqi për të gjitha subjektet tregtare që gëzojnë statusin special (11 subjekte gjithsej) dhe synimi i ligjit është që këtë përjashtim ta shtrijë dhe për 11 subjekte të tjera tregtare, të cilat janë në proces të përfitimit të këtij statusi.
15. Çështja që duhet të zgjidhte Komisioneri në shqyrtimin e denoncimit është, nëse këto 11 subjekte tregtare formojnë “kategori të caktuar të popullsisë”, në kuptimin e pikës 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, apo jo. Kjo përgjigje kushtëzon përfshirjen e këtij ligji në rastet e ndalimit sipas pikës 4 të nenit 91 ose përjashtimin e tij nga ky ndalim.
16. Sikurse është sqaruar më lart në parim, KAS-i, nga ana e tij, nuk e gjen këtë ligj në të përfshirë në rastet e ndalimit, sepse:
 - a) kategoria e përfituesve nuk formon “kategori të caktuar të popullsisë”. Subjektet janë subjekte tregtare;
 - b) numri i këtyre subjekteve është ekstremisht i ulët;
 - c) krijimi i lehtësisë nuk bëhet për qëllime elektorale, por për të siguruar barazi në konkurrueshmëri dhe në statusin ligjor të të gjithë anëtarëve të kategorisë;
 - d) Pozita e veçantë në tregun e sipërmarrësve turistikë që gëzojnë këto subjekte nuk e bën të besueshme hipotezën, se për shkak të përjashtimit për 10 vjet nga taksat mbi të ardhurat

korporative, këto subjekte do të nxiten që të përfshihen në një fushatë ndikimi të paligjshëm në zgjedhje, mbi personat që janë në marrëdhënie pune me ta.

17. Mbi këtë arsyetim Komisioneri duhet të kishte rrëzuar si të paligjshme kërkimet e denoncuesit dhe të kishte pushuar hetimin e denoncimit.
18. Në fakt, Komisioneri ka përfshirë në shqyrtim administrativ dy çështje, të cilat nuk kanë qenë objekt i denoncimit, projektligjin “Për paketën e maleve” dhe projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
19. Komisioneri ka arsyetuar se fusha e veprimit të dy projektligjeve “prek politika të rëndësishme fiskale” dhe se “ndryshimet e propozuara kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar, çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve. Ato mund të krijojnë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale”. Në përfundim të shqyrtimit Komisioneri ka vendosur që “t’i rekomandohet Kuvendit të Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare”.
20. KAS-i e gjen të pambështetur në ligj këtë vendimmarrje të Komisionerit. Propozimi, miratimi apo nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore ndalohet jo kur ka lidhje me fusha apo sektorë të caktuar, as kur prek politikat sektoriale, por kur sjell përfitime për kategori të caktuara të popullsisë. **Pa përfitim nuk ka ndalim.**
21. Projektligji “Për paketën e maleve” është propozim i Këshillit të Ministrave, i depozituar në Kuvend në datën 10.01.2025, jashtë periudhë së ndalimit. Projektligji është një akt procedural, i cili:
 - a) përcakton procedurat për shpalljen e zonave malore me përparësi zhvillimi;
 - b) vendos rregullat për zhvillimin e pasurive shtetërore të poseduara pa titull pronësie nga subjektet private në këto zona, në harmoni me rregullat e legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 - c) krijon bazën ligjore për kalimin e pronësisë nëpërmjet shitjes me tarifën simbolike 1 (një) euro të këtyre pasurive të paluajtshme shtetërore, të cilat rezultojnë të jenë në posedim faktik të poseduesëve jo pronarë.
22. Projektligji për “Paketën e maleve” nuk sjell në vetvete përfitime për kategori të caktuara të popullsisë. Përfitimi i pasurive të caktuara mund të bëhet sipas këtij ligji, nëpërmjet aplikimit, në rast se pasuria ndodhet brenda zonave me prioritet zhvillimi (të cilat duhet të shpallen pas hyrjes në fuqi të ligjit), pas përfundimit të procedurës së regjistrimit fillestar të zonave kadastrale që përfshihen në zonën për zhvillim ose pas përfundimit të procedurave për përmirësimin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në projektligj parashikohet se rregulla të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për pushtetin vendor, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

23. Po kështu, procedura e aplikimit dhe shqyrtimit të kërkesave, si dhe procedura e kalimit nëpër hallkat e ndryshme vendimmarrëse parashikon afate, të cilat parashikojnë kohëzgjatje të konsiderueshme dhe që tejkalon ndjeshëm periudhën e ndalimit.
24. Projektligji për “Paketën e maleve” nuk mund të përfshihet në rastet e ndalimit, sepse:
- akti është një akt kuadër, i cili nuk sjell automatikisht përfitime;
 - kategoria e popullsisë që përfiton prej tij është e papërcaktueshme, sepse janë të papërcaktuara zonat me prioritet zhvillimi;
 - plotësimi i kuadrit ligjor me aktet zbatuese është parashikuar të marrë kohë, e cila mund të shkojë nga disa muaj deri në disa vite. Praktikrat e ngjashme burokratike përmbajnë bollshëm shembuj, që flasin për vonesa disa vjeçare, kur bëhet fjalë për ligje që kërkojnë plotësim të kuadrit ligjor, në rastet kur parashikohet akordimi i përfitimeve dhe lehtësirave për grupe të caktuara të popullatës.
 - është e pamundur që me miratimin vetëm të këtij ligji të përcaktohet rrethi i personave të targetuar, gjë që përjashton mundësinë që miratimi i këtij ligji të ketë impakt mbi vullnetin elektorale të personave specifikë.
25. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” është propozim i deputetit Erion Braçe, i depozituar në Kuvend në datën 17.01.2025, brenda periudhës së ndalimit. Qëllimi i projektligjit është që të përsosë mekanizimin e deklarimit të TVSH-së në sektorin e bujqësi-blegtorisë, për ta bërë mekanizimin të drejtë, racional, transparent dhe të aplikueshëm për grumbulluesit e produkteve bujqësore, duke barazuar në këtë mënyrë kushtet e konkurrencës me importuesit.
26. Projektligji nuk krijon lehtësi, nuk heq dhe as redukton TVSH-në për asnjë nga subjektet e sektorit. Nëpërmjet mekanizmit të “auto faturimit”, ai u jep mundësinë grumbulluesve që të zbatojnë drejt rregullat e TVSH-së (si diferencë midis TVSH-së në shitje me atë në blerje), në rastet kur prodhuesit bujqësorë e blegtoralë të përjashtuar nga skema e TVSH-së hyjnë në transaksione me grumbulluesit. Propozimi rregullon tregun, por nuk ndjek qëllime elektorale. Nëse rregullat e deritanishme kanë shkaktuar një favorizim të padrejtë të importuesve, propozimi synon që të heqë këtë favorizim dhe të kthejë “drejtësinë” në treg.
27. Analiza e mësipërme tregon se për dy projektligjet nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme për të urdhëruar ndalimin e miratimit dhe nxjerrjes së tyre. Por vendimi i Komisionerit është i pambshtetur në ligj edhe për shkak se ai bie ndesh me rregullat në fuqi për formën e aktit administrativ (neni 99 i KPrA). Në përfundim të procedurës administrative, Komisioneri ka rekomanduar mos përfshirjen për shqyrtim në seancë plenare të projektligjit “Për paketën e maleve” dhe të Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ndërkohë që duhet të vendoste ndalimin e miratimit të këtyre dy projektligjeve, nëse konstatonte se vinin në kundërshtim me pikën 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Komisioneri ka disponuar me akt administrativ, në përfundim të një procedure të hetimit administrativ. Aktet administrative dallohen nga

komunikimet e tjera zyrtare nga fakti që ato kanë forcë detyruese, nxirren sipas një procedure rigjide dhe garantojnë të drejta të palëve, përfshirë të drejtën e ankimit ndaj tyre. Akti administrativ i Komisionerit nuk rekomandon, por urdhëron. Rekomandimi nuk ka forcë detyruese, ndërkohë që aktet e komisionerit, vendimet, urdhërat dhe udhëzimet kanë forcë detyruese. Një akt administrativ që është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ është një akt administrativ i paligjshëm (shkronja “c” e nenit 109 të KPrA).

28. Në përfundim dhe në përmbledhje të sa më sipër, KAS-i konstaton se pika 2 e dispozitivit të vendimit të Komisionerit nr. 83, datë 11.02.2025 duhet të shfuqizohet, sepse është jashtë objektivit të çështjes në shqyrtim, është formuluar si rekomandim dhe jo si urdhërim, në kundërshtim me formën e kërkuar nga neni 99 i KPrA, si dhe është në kundërshtim me pikën 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, për shkak se të dy projektligjet e referuara nuk bëjnë pjesë në rrethin e akteve, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë.
29. Kërkimi për shfuqizimin e pikës 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionerit nr. 83, datë 11.02.2025 duhet të pranohet, por nuk ka vend që të pranohet kërkimi për konstatimin se asnjëri prej projektligjeve të sipërpërmendura nuk bie ndesh me nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor, sepse ky kërkim nuk ka objekt. Konstatimi i pajtueshmërisë apo papajtueshmërisë është pjesë përbërëse e arsytimit që lidhet me kërkimin e parë, por jo kërkim i veçantë. Po kështu, nuk ka vend që KAS-i të shprehet për kërkimin e tretë, atë për lejimin e vijimit të procedurave parlamentare, sepse në momentin që bie ndalimi, është në lirinë e plotë të Kuvendit që të procedojë për shqyrtimin e mëtejshëm të projekt akteve, në përputhje me agjendën e tij. Për këtë nuk nevojitet leje e posaçme, aq më tepër nga organet drejtuese të zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21 pika 1 shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 1, datë 14.02.2025 të depozituar nga Kuvendi i Shqipërisë.
2. Shfuqizimin e pikës nr.2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative“, të ndryshuar” mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.

Njoftuar palëve të pranishme me shpalljen.

U shpall sot, më datë 19.02.2025.

Elvis	ÇEFA	-	Relator	(Pjesërisht Kundër)
Elvin	LAKO	-	Anëtar	
Koli	BELE	-	Anëtar	(Mendim paralel)
Iirjan	RUSMALI	-	Anëtar	
Ledio	BRAHO	-	Anëtar	(Pjesërisht Kundër)

MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 1, datë 14.02.2025 të paraqitur nga Kuvendi i Shqipërisë me objekt “Kundërshtimin e pikës 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ne anëtarët në pakicë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS), jemi pjesërisht kundër vendimit të shumicës për shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të KSHZ, ndaj paraqesim në vijim argumentet tona për këtë qëndrim:

1. Në vlerësimin tonë, KAS në këtë vendimmarrje nuk ka arritur në një konkluzion të drejtë lidhur me konstatimin se rekomandimi i bërë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në pikën 2 të vendimit të tij objekt ankimi, që Kuvendi i Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjin “Për paketën e maleve”, nuk qëndron.
2. Karakteristika e përbashkët e iniciativave që ndalohen në dispozitat e cituara në vendimin objekt ankimi ka të bëjë, me masa/nisma ligjore në favor të kategorive të caktuara të popullsisë, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt mbi pasurinë publike ose shtetërore. Qeveria nuk mund të propozojë dhe Kuvendi nuk mund të miratojë apo nxjerrë akte, me të cilat disponohet mbi pasurinë e shtetit, në favor të kategorive të caktuara të popullsisë.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në pikën 2 të vendimit objekt ankimi ka analizuar dhe konkluduar drejtë për sa i përket faktit se projektligji “Për paketën e maleve” ka *“...një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar, se çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve dhe se ato mund të krijojnë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale.”*.
4. Dukshëm qëllimi i ligjvënësit nëpërmjet dispozitave të materializuara në pikën 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe pikën 3 të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, është krijimi i një klime “barazie armësh” ndërmjet forcave politike në qeveri dhe atyre në opozitë në periudhën para, gjatë dhe pas fushatës elektorale. Më konkretisht, këto dispozita kanë si qëllim ndalimin e dhënies së lehtësive, ndihmave, përfitimeve me karakter financiar dhe/ose pasuror për kategori të caktuara të popullsisë, në periudhën para dhe pas zgjedhjeve, pasi këto lehtësi, ndihma apo përfitime mund të bëhen me synim për të ndikuar vullnetin e zgjedhësve, në zgjedhjet për Kuvendin.
5. **Pikërisht në zbatim të këtij ndalimi, Komisioni Rregullator, në pikën 5 të nenit 5 të vendimit të sipërcituar ka përcaktuar se “Në zbatim të ndalimit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave marrin masa për të mos vendosur ose propozojnë të mos vendosen në rend të ditës të institucioneve respektive për shqyrtim dhe miratim, aktet e përmendura në pikën 3 të këtij neni”, çka do të thotë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencën që në këtë rast, me vendim, të detyrojë Kryetarin e Kuvendit për të ndaluar vendosjen në rend dite të nismave që bien ndesh me nenin 91 pika 4 të K.Zgjedhor.**

6. Në lidhje me themelin e pretendimit, pra nëse kjo nisëm ligjore i plotëson kushtet për t'u klasifikuar si një nisëm e ndaluar në zbatim të nenit 91 pika 4 e K.Zgjedhor, arsyetohet në mënyrë specifike krerët II dhe III të projektligjit "Për paketën e maleve", në të cilët përcaktohet procedura e njohjes si "posedues jo pronar" e personave juridikë apo individëve të ndryshëm, miratimi i lejes së zhvillimit pavarësisht faktit se nuk është fituar ende titulli i pronësisë mbi një pasuri shtetërore të caktuar dhe më tej blerja e kësaj pasurie në vlerën simbolike prej 1 (një) euro, qartësisht parashikojnë dhënien e një përfitimi për një kategori të caktuar të popullsisë në kuptim të pikës 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Ky përfitim mund të përdoret nga kandidatët e partive politike të mazhorancës qeverisëse në mbështetje të fushatës së tyre elektorale dhe si i tillë, të ndikojë në mënyrë jo proporcionale në rezultatin e votimit në zgjedhjet e datës 11 maj 2025.
7. Ne anëtarët në pakicë, vlerësojnë gjithashtu se konkluzioni i KSHZ, i materializuar në pikën 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, për të "rekomanduar" Kuvendin që të mos përfshijë në seancë plenare projektligjin "Për paketën e maleve", është nxjerre në interpretim të gabuar të ligjit. Ligji i aplikueshëm në këtë rast, nuk ka përdorur në asnjë dispozitë termin "rekomandim" për të ndaluar një veprimtari të caktuar, sikurse ka disponuar KSHZ. Por, referuar pikës 1 të nenit 9 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka të gjitha kompetencat dhe madje edhe detyrimin që të urdhërojë institucion shtetëror (në këtë rast Kryetarin e Kuvendit) që të ndalojë veprimtarinë që bie ndesh me pikën 3 të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Për këto arsye, për mendimin tonë, KAS në shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr. 1, datë 14.02.2025 të paraqitur nga Kuvendi i Shqipërisë me objekt "Kundërshtimin e pikës 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve", duhet të kishte vendosur:

- *Pranimin e pjesshëm të ankimit,*

- *Ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke ndaluar vendosjen në rend të ditës në seancë plenare të projektligjit "Për paketën e maleve".*

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**

MENDIM PARALEL

Unë anëtari Koli Bele, duke qenë dakord me dy anëtarët e KAS për shfuqizimin e Vendimit nr. 83, datë 11.02.2025 ‘Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 4 ID, datë 06.02.2025, të KRIIK’, të KSHZ, por jo me analizën ligjore dhe ligjin e aplikueshëm, paraqes arsyetimin tim si vijon:

1. Kolegët e shumicës shprehen se Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të tij, ka arsyetuar gabim përputhshmërinë e projektligjeve objekt hetimi administrativ dhe kanë vijuar me analizën e këtyre projektligjeve nëse janë në përputhje ose jo me Kodin Zgjedhor. Në të njëjtën mënyrë dhe dy anëtarët në pakicë kanë arsyetuar se KSHZ ka tagrin të monitorojë procesin e miratimit të akteve në Kuvend dhe do të duhej të shprehte ndalimin e shqyrtimit të njërit prej këtyre akteve.
2. Çmoj se kjo vendimmarrje e KSHZ nuk është në tagrin e këtij organi të KQZ, pasi Kodi Zgjedhor nuk parashikon monitorimin dhe aq më pak pezullimin apo ndalimin e Kuvendit në kryerjen e funksioneve të veta kushtetuese ligjvënëse, qoftë edhe në formën e rekomandimeve të formalizuara si vendime të KSHZ.
3. Procesi ligjvënës është i rregulluar në mënyrë të veçante në Kushtetutë në nenet 81-85 dhe një organ i krijuar me ligj të veçantë, siç është KSHZ, nuk mund të marrë tagrin për të vendosur mbi ushtrimin e funksioneve dhe kompetencat e një organi kushtetues, siç është Kuvendi. Nëse do pranohet një fakt të tillë, atëherë dhe organe të tjera të krijuara me ligje të veçanta, si p.sh Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ose Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, etj., të cilat kanë në ligjet përkatëse të drejtën dhe detyrimin për të garantuar zbatimin e legjislacionit të fushës që mbulojnë, do të kërkonin mos miratimin e akteve ligjore nga Kuvendi në rastet që vlerësojnë se ka konflikt me ligjin e tyre organik, gjë që nuk pranohet nga kuadri dhe logjika ligjore .
4. Një arsye tjetër që mbështet qëndrimin se KSHZ nuk ka kompetenca të tilla, është parimi ligjor i parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës i ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Mekanizmin e ‘ndërhyrjes’ dhe kontrollit në veprimtarinë ligjvënëse të Kuvendit, Kushtetuta ja ka përcaktuar përjashtimisht Presidentit të Republikës në nenin 85 të Kushtetutës, i cili ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjit vetëm një herë; dhe Gjykatës Kushtetuese që ushtron kontrollin mbi bazën e ankimit të rregulluar, në mënyrë shteruese nga Kushtetuta dhe ligji.
5. Kompetencat e KSHZ janë renditur në mënyrë shteruese në nenin 19 të Kodit Zgjedhor. Shkronja ‘dh’ e pikës 1 të këtij neni përcakton se: (Komisioneri) *‘kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit’*.

6. Ky parashikim nuk mund të interpretohet në mënyrë të zgjeruar, bashkë me nenin 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor, se Komisioneri mund të vendosë ndalimin e Kuvendit për të miratuar ligje të caktuara në zbatim të funksioneve të veta kushtetuese. Duhet kuptuar se Komisioneri kujdeset për zbatimin e Kodit Zgjedhor, por brenda kompetencave të tij, dhe jo në mënyrë të pakufizuar për çdo akt ligjor dhe për të gjithë legjislacionin e aplikuar në Republikën e Shqipërisë. Aty ku ligjvënësi ka patur qëllimin që t'i japë kompetencë Komisionerit, dhe KAS si organ i KQZ, për të vepruar nëpërmjet akteve apo sanksioneve e ka bërë këtë në mënyrë të shprehur.
7. Në një analizë paralele, Ligji nr. 8454/1999 'Për Avokatin e Popullit', i ndryshuar, në nenin 2 të tij, parashikon se: *“Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend....”*
8. Ky parashikim, në qëllimin e tij, është i ngjashëm me parashikimin e Nenit 19/1/dh që i referohet kompetencës së KSHZ për t'u kujdesur për zbatimin e ligjit nga të gjitha institucionet. Ndërkohë, Neni 24 i ligjit 'Për Avokatin e Popullit', e drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative, parashikon se:
9. *Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre, shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:*
- a): t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;*
- b): t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mos shqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.*
- c): të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla.*
- Pra ligjvënësi ka përcaktuar të drejtën për të rekomanduar ndryshime apo vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e aktit, nëpërmjet kontrollit *aposteriori* të aktit të miratuar.
10. Në mënyrë të ngjashme në Ligjin Nr.154/2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 17- Konsultimi dhe dhënia e opinionëve, është normuar kompetenca e KLSH, konkretisht në pikën 1: *“Për çështje që kanë të bëjnë me hartimin e një projektligji që lidhet me funksionin, veprimtarinë, detyrat dhe kompetencat e KLSH, organet shtetërore konsultohen paraprakisht me KLSH”*,

dhe në pikën 3 të këtij neni, e drejta e KLSH të bëjë propozime për ndryshime në legjislacion. Në nenin-18 Revokimi dhe ndryshimi i akteve, gjejmë të njëjtin mekanizëm si në sipërpërmendur të Avokatit të Popullit.

11. Në rastet e këtyre dy institucioneve të pavarura që parashikohen në Kushtetutë, ligjvënësi ka treguar “ kujdesin e nevojshëm“ duke rregulluar procedurën si mund të rekomandojnë ndryshimet apo kërkojnë shfuqizimin e një ligji, duke i vendosur si subjekte të posaçme të gjykimit kushtetues, pasi ligji të jetë miratuar.
12. Në mungesë të një rregullimi të posaçëm ligjor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përmbushje të funksionit të tij, mund të kontribuojë në procesin legjislativ, duke u përfshirë në procedurën e konsultimeve me grupet e interesit, siç në fakt ka bërë së fundmi gjatë diskutimeve për ndryshimet ligjore në Kodin Zgjedhor. I njëjti mekanizëm vlen dhe aplikohet për rastet e organeve të tjera që krijohen me ligje të veçanta, që mund të kontribuojnë në procesin e shqyrtimit të projektligjeve në komisionet përkatëse parlamentare, por asnjë institucion tjetër, përfshi ato kushtetuese si Avokati i Popullit apo KLSH, apo komisionerë të tjerë publikë të krijuar më ligje të veçanta, nuk kanë tagër për të ndaluar procesin e shqyrtimit të projektligjeve duke nxjerre akte administrative për këtë qëllim, si në formën e rekomandimeve për heqjen nga agjenda e komisioneve parlamentare dhe aq më pak në formën e një akti ndalues, siç arsyetohet nga anëtarët në shumicë të KAS!
13. Nëse do pranohet argumentin e kundërt se KSHZ e ka një kompetencë të tillë, pra mund të pezullojë ose ndalojë projektligjin në momentin e shqyrtimit në komisionet e Kuvendit, duke vlerësuar *prima facia* siç është rasti objekt shqyrtimi, se projektligji bie në sferën e ndalimeve të nenit 91.4, si mund të paragjykojmë ose të përjashtojmë mundësinë që komisionet parlamentare dhe në fund Kuvendi në seancën plenare, duke bërë amendime të ndryshme, do i përmbaheshin detyrimeve dhe ndalimeve që parashikon Kodit Zgjedhor në nenit 91.1 !?
14. Si mund të përjashtojmë gjithashtu mundësinë që procesi i miratimit të ligjit mund të shkojë përtej periudhës së ndalimit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, pasi është fakt i njohur, por dhe siç u parashtrua në seancën e shqyrtimit në KAS, procese të tilla mund të marrin disa muaj ose edhe vite ose projektligji dhe mund të mos kalojë për miratim në seancën plenare apo mos të marr votat e nevojshme!?
15. Parashikimet e pikës 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga institucionet publike, në rastin konkret edhe nga Kuvendi. Kodi Zgjedhor nuk ka parashikuar një mekanizëm procedural ndalues apo korigjues, për rastin kur Kuvendi do miratonte një akt ligjor që bie në kundërshtim me këtë normë. Po ashtu nuk ka një normë procedurale që do të bënte të mundur parandalimin e miratimit, duke ndaluar *de facto* procesin e miratimit të ligjeve gjatë shqyrtimit në komisionet parlamentare.

16. Në rastin konkret, Komisioneri ka vepruar tej kompetencës së tij, dhe për këtë arsye, vendimi i tij duhet të shfuqizohet.
17. Një shkak tjetër që çon në shfuqizimin e vendimit të Komisionerit është fakti se Komisioneri nuk mund të nxjerrë rekomandime, por vetëm Vendime, Urdhra dhe Udhëzime, siç përcaktohet dhe në pikën 2 të nenit 19 të Kodit Zgjedhor. Bazuar në nenin 109, shkronja ‘c’ të Kodit të Procedurave Administrative, Vendimi nr. 83, datë 11.02.2025 ‘Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 4 ID, datë 06.02.2025, të KRIIK i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ dhe për pasojë konsiderohet i paligjshëm, siç me të drejtë është arsyetuar dhe nga anëtarët e shumicës.

Koli Bele - Anëtar